

INTERTEKSTUALITETI NË VEPRËN “VAJZA E AGAMEMNONIT” TË ISMAIL KADARESË

Kaltrina SADIKI-MEMETI¹

¹Gjuhë dhe Letërsi Shqipe, Fakulteti Filologjik, Universiteti i Tetovës

²Corresponding author e-mail: kaltrina.sadiku@unite.edu.mk

Abstrakt

Në këtë punim është trajtuar tema e intertekstualitetit në veprën e Ismail Kadaresë “Vajza e Agamemnonit”. Është analizuar prania e një teksti tjetër brenda veprës “Vajza e Agamemnonit”. Janë analizuar lidhjet në mes të teksteve dhe mënyra se si integrohet teksti i huaj brenda veprës më saktësisht se si bëhet lidhja mes hipotekstit dhe hipertekstit. Përmes analizës së teksteve është zbuluar që dy janë teknikat që bijen më tepër në sy që autori i përdor për ndërlidhje të teksteve aluzioni dhe citatshmëria duke e theksuar më tepër të dytën.

Qëllimi i këtij punimi do të jetë që përmes analizës së të dy teksteve dhe arsytet e lidhjeve mes tyre të anlizojë edhe universalitetin e viktimave dhe tiranëve, pavarësisht kohës kur këta jetojnë dhe kulturës që i takojnë. Qëllim do të jetë edhe që duke analizuar këto dukuri të na ndihmojë të zbulojmë më shumë për karakteret njerëzore dhe për fenomenet shoqërore; të na ndihmojë të kuptojmë psikologjinë e turmës dhe psikologjinë e sundimit tiranik. Do të tentohet të zbulohet çfarë e lidh vajzën e Agamemnonit nga lashtësia dhe kultura greke me kulturën shqiptare dhe personazhin e Kadaresë të shekullit të XX.

Përmes këtij punimi do të tentohet të dëshmohet fakti që historia dhe e kaluara përsëriten, se karakteret njerëzore janë po ato nga lashtësia dhe deri sot. Duke qenë kështu origjinaliteti humbet brenda teksteve sepse gjithçka që mund të thuhet a mendohet, është thënë e përjetuar më parë.

Fjalët kyçe: *Intertekstualitet, Kadare, tirani, citatshmëri, Ifigjina.*

Abstract

In this paper, is addressed the topic of intertextuality in Ismail Kadare's book "The Daughter of Agamemnon".

It has been analyzed the presence of another text inside the book "Daughter of Agamemnon", the links between the texts and the way the foreign text is integrated in the book, more precisely it has been analyzed how hypotext and the hypertext have been connected. Through the analysis of the texts, it has been revealed that the two techniques that stand out the most are the allusion and the citation, the second one stands out more. The purpose of this paper will be that by analyzing these texts and the connections between them to be able to analyze the universality of tyrants and victims despite the time they lived in and the culture they belong to. Its purpose will also be to help us discover more about human characters, social phenomena and to help us understand the crowd psychology and the psychology of tyrannical rule.

It will be attempted to find out what connects Agamemnon's daughter from antiquity and Greek culture with Albanian culture and the character of Kadare in the 20th century.

Through this paper, we will try to prove the fact that history and the past repeat themselves, that human characters are the same from ancient times to today. So in this way originality is lost within the texts because everything that can be said or thought has been said and experienced before.

Key words: *Intertextuality, Kadare, tyranny, citation, Iphigenia.*

1. Intertekstualiteti si fenomen në letërsi dhe si i tillë në veprën “Vajza e Agamemnonit”

Përpara se të nisim të analizojmë intertekstualitetin në veprën e Kadaresë së pari është e udhës të sqarojmë çfarë kuptojmë me intertekstualitet.

Sipas studiuesve intertekstualiteti paraqet interaksion ose dialog mes dy apo më shumë teksteve apo mes një teksti dhe kontekstit.¹

Pse ekziston ky interaksion kjo lidhje mes teksteve, si shpjegohet kjo në kohërat e sotme dhe a quhet “vjedhje” ndërfitja e një teksti brenda tekstit tjetër, janë pyetjet të cilave studiuesit tentojnë edhe sot t’u përgjigjen. Shumë studiues mendojnë se nuk ka askund tekste plotësisht origjinale.

Për shkak të idesë së mosekzistimit të origjinalitetit absolut studiuesit kanë dhënë mendimet e tyre rreth asaj se si duhet të quhen tekstet të cilat janë të pranishme brenda teksteve të tjera. Pra, ato mendojnë se teksti nuk ka pavarësi. Lidhur me këtë Graham Allen thotë: “Tekstet, qofshin letrare apo joletrare, nga teoricienët modernë shihen si pa asnjë lloj kuptimi të pavarur. Këto tekste teoricienët i quajnë nëntekste.”²

Në anën tjetër Barti mendon se teksti është ind citatesh kurse shkrimtari imitues. Ai thotë: “Teksti është një ind citatesh i nxjerrë nga qendra e padepërtueshme e kulturës. Shkrimtari mund të imitojë vetëm një gjest që është gjithmonë i mëparshëm dhe asnjëherë original.”³

Kjo gjë nuk e penalizon veprën letrare, përkundrazi e pasuron. Kuptimi i veprës letrare arrinë të përcillet më lehtë te lexuesi dhe synimet e autorit dalin lehtësisht në pah. Për këtë Gëte shprehet: “*As edhe gjeniu më i madh nuk do të kishte mundur të zhvillohet nëse do të kishte dashur gjithçka të marrë prej vetes.*”⁴

Duke pasur parasysh këtë Kadare nuk do të tentojë t’i ik teksteve paraprake dhe të krijojë diçka plotësisht origjinale duke e ditur që kjo është e pamundur. Në vend të kësaj ai do të shfrytëzojë tekstet paraprake ashtu që tekstit origjinal t’i jep bazë të fortë historike dhe ta tërheqë vijën paralele nga antikiteti deri te ditët e sotme. Kështu figura e fate tëndryshme do të na vijën në mendje gjatë leximit dhe ngjashmëritë do të na ndihmojnë në kuptojmë që pavarësisht kulturës ku zë vend vepra a kombësisë së autorit, dallimeve në kohë dhe epokë, ajo që bije në sy është universaliteti i ndjenjave dhe sjelljeve njerëzore.

Kështu udhëheqësi Agamemnon nga lashtësia dhe kultura greke ka shumë të përbashkta me udhëheqësin komunist në Shqipërinë e shekullit XX. Ashtu siç ka të përbashkta Suzana nga bashkëkohësia e tij dhe Ifgjinia nga mitologjia greke.

E kaluara dhe e tashmja takohen në veprën e Kadaresë dhe duket sikur historia në vazhdimësi e përsërit vetveten.

Substrati i veprës së Kadaresë herë është historik, si në rastin kur për krahasim me fatin e personazhit të vet e mer Stalinin dhe të birin, e herë mitologjik, si në rastin kur për krahasim e merr Ifgjininë dhe të atin Agamemnonin.

Ali Aliu duke marrë për bazë edhe komentimin e Ante Popovskit për veprën e Kadaresë, do ta vë në pah aftësinë e Kadaresë për të krijuar një botë të re imagjinative me bazë historike dhe mitike dhe në librin e tij “Don Kishoti te shqiptarët” do të thotë kështu: “Ismail Kadaresë i shkon për dore të krijojë universin imagjinar, brenda të cilit, me një shkëlqim fare të veçantë, rrezatojnë grimca reale të fenomenit të përhershmerisë njerëzore në kohë dhe në hapësirë – të jetës dhe

¹ Aliu, Ali, *Don Kishoti te shqiptarët*, Mikenë, Manastir, 2008, f. 179.

² Krifca- Beqiri, Mirlinda, *vep. cit.*, f. 163.

³ Kadare, Ismail, *Vajza e Agamemnonit*, Shtëpia botuese '55, Tiranë, 2003, f. 20.

⁴ Kadare, Ismail, *vep. cit.*, f. 69.

vdekjes. Imagjinaria e kësaj bote, siç do të vërejë Ante Popovski, mbase është rezultat i substratit mitologjik që përzihet herë pas here me historinë dhe herë me bashkëkohësinë...”⁵

2. Teksti dhe interteksti në vepër mënyra e ndërlidhjes

Në veprën e Kadaresë teksti dhe nënteksti ndërlidhen me njëri-tjetrin përmes shembujve nga letërsia që i vijnë në mendje personazhit kryesor të veprës për situatat “reale” në botën e vetë.

Studiuesit mendojnë që autorët e mëdhenj, përgjithësisht, kanë qenë të vetëdijshëm se “vjedhja” në letërsi është e njohur, por se mjeshtëria e autorit vjen në shprehje në mënyrën si realizohet ajo. “Të gjithë e njohim mjeshtërinë e krijimit të librit të ri prej disa librave të vjetër”. Sot madje, nuk mungojnë edhe rastet kur autori i ri vet e orienton lexuesin drejt burimeve të veta, duke u shërbyer me ndonjë referencë, si në rastin e T.Eliot, ose raste kur, në shkrime të veçanta, autori mundohet të zbulojë mjaft relacione intertekstuale, siç është rasti me U. Eko-n.⁶

Një rast i tillë është edhe Kadare. Ai vetë na orienton për tekstin tjetër brenda veprës së vet. Këtë e bën madje edhe duke përdorur citate.

Kryesisht na bien më shumë në sy dy teknika të cilat autori i përdor për ndërlidhjen mes teksteve: aluzioni dhe citatshmëria duke e theksuar më tepër të dytën.

Përmes analogjive të cilat personazhi kryesor në vepër i bën lidhur me ngjarjet dhe situatat në jetën e tij, në vepër bëhet ndërlidhja me hipertekstin.

Njëra ndër këto analogji është momenti kur sakrificat të cilën e dashura e tij, Suzana duhej ta bënte për hir të babait të saj, që ai të ngritej në detyrë në parti i duket personazhit si sakrificat e Ifigjnisë për të atin. Në vepër e shohim të shprehur nëpërmes këtyre rreshtave: “Kjo shtyrje në largësi duhej të kishte qenë dhe kapërcimi kryesor. Që këndeje, gjer te analogjia midis flijimit, për të cilin porsa më kishte folur Suzana dhe Ifigjnisë së grekëve, nuk kishte veçse një hap.”⁷

Në një rast tjetër stofi i kuq solemn i festës së 1 Majit, lulet e muzika, i duken personazhit si funeral, si skenë nga flijimi i Suzanës dhe i asocojnë personazhit me skenën e flijimit të Ifigjnisë. Për ta bërë edhe më të qartë këtë asocim ai ndërftu vargjet si vijojnë:

Lutjet dhe thirrjet ndaj të atit

As edhe moshë e saj virgjine s’prekën

Shefat e ndërkryer keq për luftë⁸

Madje ai shkon edhe më tej dhe thotë: “Më qartë se Kasandra unë shihja arkivolet dhe sëpatën e përgjakur mbi altar.”⁹

Kjo festë i ngjason atij si nisma e një kasaphane. Një luftë ku për t’u arritur kënaqësia e liderit dhe për të arritur dikush lavdinë, shumë të tjerë do të duhej të sakrifikohehin. Për atë arsye ato që pritej të sakrifikohehin i quan arkivole.

Kurse, këshilltari i babait të Suzanës, atij i aludonte në Kallkantin, ideatorin e flijimit të Ifigjnisë.

Personazhi pyet veten: “Dinte gjë vallë për ndryshimin e ardhshëm të Suzanës? Me siguri që e dinte, përderisa që këshilltari kryesor i të atit. Dhe jo vetëm kaq. Ndoshta ishte edhe ideator i flijimit të saj. Kallkanti.”¹⁰

⁵ *Po aty*, f. 103.

⁶ *Po aty*, f. 71.

⁷ *Po aty*, f. 109

⁸ *Po aty*, f. 51.

⁹ *Po aty*, f. 107

¹⁰ *Po aty*, f. 108-109.

Atij madje edhe fytyra e tij i duket mosbesuese dhe ironike. I duket se fytyra e tij shpreh “dije të diçkaje që zakonisht s’dihet”.

Edhe vet në vepër ai përmend faktin që situata i aludon në sakrifikimin e Ifigjinisë dhe që e tashmja edhe më shumë i ngjason me mitin pasi i rastis të lexoj të njëjtin nga vepra e njohur e Robert Grejvsit “Mitet greke”. Duke përmendur këtë ai na jep madje edhe titullin e hipertekstit, na jep referencën e tij.

Përpos se me Ifigjininë greke dhe legjendën e sakrifikimit të saj, te personazhi shohim edhe analogji të situatës së sakrifikimit të Suzanës me ngjarje reale dhe historike. Konkretisht përmendet në vepër Stalini, i cili sakrificon birin e vet Jakovin në ushtri. Në këtë rast Jakovi, Suzana e Ifigjina, kishin të njëjtin fat.

Personazhi besonte se e kishte zgjedhur enigmën, se kishte gjetur arsyet e sakrifikimit të fëmijëve të vet nga ana e diktatorëve.

Sipas tij që flijuar Jakovi, ndjesë pastë, jo për të patur fatin e çdo ushtari tjetër rus, siç kishte deklaruar diktatori, por për t’i dhënë të drejtën diktatorit, t’i kërkonte vdekjen cilitdo. Ashtu si Ifigjina që i dha Agamemnonit të drejtën për kasaphanën. S’ ishte, as bindja se flijimi do të shtronte erërat që pengonin flotën, as një parim moral për barazinë e djemve të Ruisë. Ishte thjesht një përlllogaritje cinike tiranësh.”¹¹

Në vepër përpos pranisë së tekstit lidhur me Ifigjininë hasim edhe praninë e një teksti tjetër- një përralle të moçme shqiptare; përrallës mbi Qerosin.

Te ky hipertekst autori përsëri na orienton vetë. Duke folur për personazhin e vet R.Z, për sakrificat që kërkon partia prej njerëzve dhe servilizmin ai e orienton vëmendjen tonë kah përralla mbi Qerosin.

R. Z. ishte servil i partisë ishte rritur pa baba, thoshte që i është bërë nënë partia. Kur mendon për rastin e R.Z. personazhit kryesor i bije ndërmend përralla e moçme e Qerosit.

Qerosi për të dalë për të dalë nga bota e nëndheshme kupton nga një plak që ka vetëm një rrugë; të ngjitet në kurrizin e një zhgaboje e cila kërkon të ushqehet me mish. Gjatë gjithë rrugës derisa mishi të cilin e merr nga bota e nëndheshme i mbaron Qerosi e ushqen zhgabonjën. Mirëpo kur mishi i mbaron në mënyrë që zhgabonja të mos e lëshojë në humnerë ai fillon t’i jep asaj mish nga mishi i vet. Kur arrijnë në botën e sipërme njerëzit vërrejnë një zhgabonjë me një skelet njeriu në shpinë.

R. Z. një ditë i arrestohet një kushëri. Ai bën çmos që të mos lidhet emri i tij me të nga ana e partisë. I kushton vjersha liderit dhe i dërgon ato përmes fëmijëve bashkë me ankesën që për ndonjë arsye që nuk dihej të njëjtat nuk i ishin botuar; provokon një dramaturg të njohur në mbledhje partie si dhe në bazë të komentit (denoncimit) që i bën ai një kineasti të ri, kineasti arrestohet.

R. Z. për dallim nga Qerosi ushqen zhgabonjën me mish të huaj. Zhgaboja aludon në këtë rast me Partinë. Partia na paraqitet si një zhgabonjë e pangopshme që kur nuk kishte më çfarë të merr prej teje, kur ti nuk ke më çfarë të sakrifikosh për të, me çfarë ta ushqesh atë, të hiqte qafe.

Personazhi kryesor shprehet: “Të tjerë ishin ata për arsye të ndryshme, kishin prerë copa të vetvetes që fati mos t’i lëshonte të rrokulliseshin nëpër honin pa kthim...”¹²

Kjo fjali e personazhit kryesor na lë të kuptojmë që ato sakrifica të cilat i kërkonte partia nga njerëzit e vet besnikë ishin shkak që përcaktonte fatin e njerëzve prej të cilave kërkoheshin. Ishin sakrificat të cilat përcaktonin nëse do të ngritej dikush në detyrë ose “do të rrokullisej në honin pakthim.

¹¹ *Po aty*, f. 109.

¹² *Po aty*, f. 71.

3. Ngjashmëritë mes tiranëve në hipotekst dhe në hipertekst

Tirania është ajo që gjeneron veprimin brenda naracionit në hipotekst dhe në hipertekst. Ajo që vërrehet qoftë në tekst qoftë në nëntekst është që tiranët pavarësisht bindjeve të cilat i kanë; ideologjive që iu përkasin apo vendeve e kohërave prej nga vijnë, gjithmonë kanë një psikologji të ngjashme veprimi.

Pika ku vërehet lidhja mes tiranëve nga antikiteti dhe atyre nga bashkëkohësia në veper është kur krahasohen veprimet të cilat i kishte bërë Agamemnoni dhe ato që kishte bërë Stalini, si dhe ato që bënte diktatori në Shqipëri për të bindur e kontrolluar turmën.

Festa e 1 Majit në hipotekst ngjason me festën e flijimit të Ifigjinisë në hipertekst.

Personazhi për atë ditë thotë: Te gjithkush ndihej djerësitja, lodhja dhe një shkrehje e përgjithshme. Dymijë e tetëqind vjet më parë, ushtarët grekë ktheheshin, me siguri kështu, nga vendi i flijimit të Ifigjinisë.¹³

Duke përshkruar këtë situatë autori përshkruan se si ushtarëve u kishte nisur t'u duket e pakuptimtë ikja që nga flijimi i Ifigjinisë. Këto ushtarë përshkruhen "me fytyra të verdha nga pamja e gjakut në altar dhe me zbrazëtinë që dukej se s'do riparohej kurrë brenda tyre. Nuk flisnin madje edhe mendimet i kishin të rralla, të përsëritura lodhshëm. Gjithçka e lehtë, gazmore, që do të shpërndante disi mërzinë e luftës: shakatë, thyerjet e disiplinës, mbrëmjet e gëzueshme në bordel, po luhatej trembshëm tani. Përderisa shefi i madh, Agmenoni, kishte flijuar vajzën e vet, asnjë mëshirë s'do kishte për askënd. Sëpata që përgjakur tashmë..."¹⁴

Kjo situatë përngjason te personazhi me festën e 1 majit. Festën e flijimit të Suzanës. Ku njerëzit vinin e shihnin me sytë e tyre flijimin e bijëve të funksionarëve të lartë dhe kuptonin që s'mund të kundërshtonin flijimin e bijëve të tyre.

Kjo mënyrë sjelljeje, këto sakrifica qoftë të Agamemnonit, Stalinit a cilitdo diktator sipas personazhit janë thjeshtë "përlllogaritje cinike tiranësh" dhe pas tyre nuk ekzistonte kurrëfarë besimi a parimi moral që merreshin si arsye të sakrificës. Këto sakrifica ishin thjeshtë mjeti që tiranët përdorin për t'i kërkuar vdekjen cilitdo, për të forcuar pushtetin e tyre dhe për të shtrirë tiraninë e tyre sa më shumë.

Një tjetër pikë ku ngjasojnë tiranët është edhe mënyra se si përlllogaritin kujt cilën detyrë t'i japin dhe kujt cilën lloj sakrifice t'ia kërkojnë.

Kështu për njerëzit më të brishtë nuk kërkohej sakrifica të kishte të bënte me vrasje, torturë a përgjakje por me ndryshime të tjera. Siç ishte rasti i Suzanës.

Këto lloje të sakrificave kërkonin të shihej me sy përditë personi që sakrifikohej, kërkonte përgatitje psikologjike për t'u përballur çdo ditë me ndërjegjen tënde.

Tiranët kërkonin prova besnikërie. Personazhi për babain e Suzanës mendon se, ndoshta, "Udhëheqësi e kishte kuptuar natyrën e tij dhe në njëfarë mënyre, ia kishte thënë: zgjidh njërën nga të dy sëpatat. Nëqoftëse s'je i aftë të përdorësh të përgjakurën merr të bardhën! Dhe qysh tani, sa jam unë gjallë, në sytë e mi, bëj provën! Godit! E bardha, po të dish ta përdorësh, është ndoshta më e tmerrshme se tjetra."¹⁵

Si në hipotekst ashtu edhe në hipertekst, njësoj si në jetën reale, tiranët kanë bashkëpunëtorët e vet. Frymëzuesit kryesor të veprave të tyre. Këshilluesit e tyre që në shumë raste janë shkaktarët e fatkeqësive dhe ideatorët e sakrificimeve ekstreme që kërkohen prej njerëzve.

¹³ *Po aty*, f. 69.

¹⁴ *Po aty*, f. 69.

¹⁵ *Po aty*, f. 107

Këshilltari i babait të Suzanës i asocion personazhit kryesor me Kallkantin. Kurse, festa e 1 majit i ngjan atij me festën e flijimit të Ifigjinisë.

Këshilltari i fatkeqësisë i tërheq atij menjëherë vëmendjen. Ai në atë fytyrë dallon mosbesuesi dhe ironi. I kujtohet që që herën e parë që e kishte takuar nuk kishte mundur ta heq nga mendja mendimin se ai ndoshta ishte edhe “ideator i flijimit të saj. Kallkanti.”¹⁶

Në këtë pikë autori na jep vetë referencën e tekstit tjetër brenda tekstit të vet. Na ofron lidhjen mes të kaluarës dhe të sotmes. Kjo na lë të kuptojmë se që nga kohrat e lashta e deri sot tiranët kanë bashkëpunëtorë të vetit.

Këshilltarë kishe pasur edhe Agamemnoni Kallkantin , këshilltarë kishte edhe babai i Suzanës e kishin pasur edhe të tjerë të ngjashëm me to përgjatë historisë.

4. Viktima në hipotekst dhe në hipertekst

Si brenda tekstit ashtu edhe në nëntekst viktimat i ngjasojnë njëra-tjetrës. Suzana e kohës së kryepersonazhit dhe Ifigjia e grekëve kanë të njëjtin fat. Ato janë mjete të tiranit. Me to ai e arsyeton veprimin e vet tiranik përpara masës dhe i përdor ato për t’i nxitur të tjerët të realizojnë qëllimet e tij.

Kështu analogjia mes Ifigjinisë dhe Suzanës është e pashmangshme për kryepersonazhin.

Festa e 1 Majit e përforcon edhe më tepër këtë analogji. Për personazhin gjithçka në atë festë “ dhe lulet, dhe muzika dhe stofi i kuq solemn, mund t’i shkonin fare mirë mbarimit të saj. Flijimit.”¹⁷

Të njëjtat përgatitje ishin bërë edhe përpara flijimit të Ifigjinisë. E njëjta atmosferë. Veçse, flijimi i Suzanës nuk ishte i përgjakshëm. Flijimi i Suzanës ishte ideologjik ishte flijim më i tmerrshëm se i pari. Në rastin e Suzanës edhe viktima jeton për ta vuajtur deri në fund çmimin e lavdisë së tiranit.

Viktimat si në rastin e Suzanës, Ifigjinisë dhe Jakovit nuk dëgjoreshin. Zëri i tyre ishte i heshtur. Në vepër kjo ilustron përmes vargjeve si vijojejnë :

Lutjet dhe thirrjet ndaj të atit

As edhe moshë e saj virgjine s’prekën

Shefat e ndërkryer keq për luftë.¹⁸

Këto vargje i shkojnë përshtat situatës së cilësdo viktimë. Prandaj autori vet në vepër në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe qëllimshëm i përfshinë këto vargje dhe na ofron një lidhje me hipertekstin.

Ai dëshiron të dëshmojë se që nga antikiteti e deri sot qenia njerëzore ka përsëritur sjelljet e veta, ka krijuar tiranë dhe viktimat të cilët pavarësisht epokës së cilës i përkasin, i ngjasojnë njëri-tjetrit. Në rolin e viktimës në tekst dhe nëntekst na dalin tre personazhë të dukshëm Ifigjia, Suzana e Jakovi. Mirëpo, këto personazhë nuk janë të vetmit. Me to nuk mbaron cikli i viktimave por përkundrazi me to nis.

Kështu viktimat të tiranisë së sistemit bëhen një numër i madh njerzish, çdo i dyti e ndjen veten të rezikuar, të nënshtruar.

Gjatë festës së 1 Majit siç përshkruhet në vepër “te gjithkush ndihej djerësitja, lodhja dhe një shkrehje e përgjithshme. Dymijë e tetëqind vjet më parë, ushtarët grekë ktheheshin, me siguri kështu, nga vendi i flijimit të Ifigjinisë.”¹⁹

¹⁶ *Po aty*, f. 108-109.

¹⁷ *Po aty*.

¹ Prince, F.T.: Introduction, në Milton, Samson Agonistes, Oxford University Press, Hong Kong, 2000, fq. 13-14

² *Po aty*

Me këto dy rreshta autori në vepër ia del të përshkruaj ndjesitë e njerëzve që ndjejnë se nuk mund t'i ikin dorës së rrëndë tiranike të sistemit, ngushtimit për të qenë të nështruar, të ndjerit si pa zgjidhje përpara gjesteve maramendëse të tiranit, i cili nuk ndalet as para sakrifikimit të asaj që ka më të shenjtë- fëmijëve të vet. Në këto dy reshta jepet edhe lidhja e menjëhershme me hiprtektstin. Autori pa vështirësi i ndërlihdh si hipoteksin me hipertekstin ashtu edhe të kaluarën me të tashmen.

Duke përshkruar në vepër situatën e sakrifikimit autori përshkruan se si ushtarëve grek kishte nisur t'u duket e pakuptimtë ikja që nga flijimi i Ifigjnisë.

Ai ndërftut një pjesë nga teksti i Grejvsit ku ushtarët, në këtë rast viktimat e ardhshme të grykësisë së tiranit përshkruhen njësoj si njerëzit pas celebrimit të festës së 1 Majit “me fytyra të verdha nga pamja e gjakut në altar dhe me zbrazëtinë që dukej se s'do riparohej kurrë brenda tyre.”²⁰

Për të përshkruar më mirë efektin e sakrificës mbi viktimat e rradhës në vepër ndërftutet ky fragment: “Nuk flisnin madje edhe mendimet i kishin të rralla, të përsëritura lodhshëm. Ushtarit Teukër, që kishte vendosur të dezertonte qysh në ndeshjen e parë të brutalitetit të tij, i dukej tani e largët kjo ide. Dhe po aq i pakuptimtë i dukej ushtarit tjetër, Idomeneut, vendimi për t'i kthyer fjalë komandantit në rastin e parë të brutalitetit të tij. Kurse Astianaksit, i cili kishte vendosur të ikte pa leje te e fejuara, vendimin që, sa më shumë e digjte malli për të, aq më i lehtë dukej, tani ngjante i pamundur. Gjithçka e lehtë, gazmore, që do të shpërndante disi mërzinë e luftës: shakatë, thyerjet e disiplinës, mbrëmjet e gëzueshme në bordel, po luhatej trembshëm tani. Përderisa shefi i madh, Agmenoni, kishte flijuar vajzën e vet, asnjë mëshirë s'do kishte për askënd. Sëpata qe përgjakur tashmë...”²¹

Kështu njësoj si dymijë e tetëqind vjet më parë në mendjen e njerëzve që kishin qenë dëshmitarë të flijimeve në festën e 1 Majit vërtiteshin të njëjtat mendime. Mendimet rreth sakrificave që duhej të bënin ata për pushtetin përderisa edhe fëmijët e shefave po sakrifikonin për të. Mendimet rreth gëzimeve të jetës prej të cilave duhej të hiqnin dorë si dhe mendimet rreth tretjes së ngadaltë në shërbim të pushtetit.

Përfundimi

Nga analiza e bërë në punim vijmë në përfundim se autori ndërftut në veprën e vet një tekst tjetër dhe madje na jep rreferenca të sakta për tekstin e ndërftutur në vepër. Ai vet na orienton drejt tij.

Shohim që fragmentet e shkëputura nga tekstet e tjera i japin veprës më shumë qartësi, e bëjnë më tërheqëse për kureshtjen e lexuesit dhe më qartë na ndihmojnë ta kuptojmë veprimin e personazhit.

Duke analizuar hipertekstin dhe arsyet e integritit të të njëjtit në vepër, vijmë në përfundim që ndonëse mund të ndërrojë epoka, ndonëse mund të ndryshojnë shumë gjëra në jetë, natyra njerëzore mbetet po ajo. Viktimat, tiranët e sistemet njësoj shfaqen brez pas brezi.

Vijmë në përfundim që jo rastësisht na vijnë në mendje ngjarje nga e kaluara për situatat e sotshme. Se jo rastësisht ngjasojnë veprimet e tiranëve dhe sjelljet e viktimave. Sepse, si në të kaluarën e deri sot njësoj funksionon psikologjia e tiranëve dhe ajo e viktimave. Dhe njësoj funksionon njerëzimi në përgjithësi. Gjithmonë për hirë të një ideali a ideologjie, për qëllime të

³ Po aty

⁴ Po aty, fq. 89-144. Për analiza të mëtejme shih edhe Stein, A., *Heroic Knowledge. An Interpretation of Paradise Regained and Samson Agonistes*. Hamden, Archon Books, 1965; Radzanovic, M.H.: *Samson Agonistes, The Divided Mind in John Milton, Modern Critical Views*. Ed. Harold Bloom. New York, 1986; Tillyard, E.M.W., vep. e cituar fq. 282-294

një individ a një grupi njerëzish, ka pasur dhe do të ketë viktime. Qenia njerëzore nuk mund të jetë tërësisht origjinale as në veprimet e veta, sepse në nënvetëdijen e vet janë të gdhendura metodat e veprimit në situata analoge.

Vijmë në përfundim që intertekstualiteti është i natyrshëm sepse as në sjelljet njerëzore dhe as në jetë nuk ka asgjë tërësisht origjinale.

Punimi tenton të hap shtigje për analiza të ngjashme në vepra të tjera, apo të hap shtigje për analizë të intertekstualitetit në të njejtën vepër në pikpamje të reja, jo vetëm në pikpamjen e tiranëve dhe viktimave, por edhe të sistemve, periudhave apo në pikpamjen e mënyrës së ndërtimit të veprës . Punimi synon të vë në pah rëndësinë e analizimit të intertekstualitetit në vepra.

Literatura e shfrytëzuar:

- [1]. Aliu, Ali, *Don Kishoti te shqiptarët*, Miken, Manastir, 2008.
- [2]. Allen, Graham, *Intertextuality*, Routledge, Milton, Abingdon, 2011.
- [3]. Kadare, Ismail, *Vajza e Agamemnonit*, Shtëpia botuese '55, Tiranë, 2003.
- [4]. Krifca- Beqiri, Mirlinda, *Studime letrare*, Vatra, Shkup, 2013.